

AHMET PRENÇI  
**ANJA**  
ROMAN

---

BOTIMET TOENA



Ahmet Prençi

*Anja*

roman

Botimet Toena  
Tiranë, 2020

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktor: Shefqet Meko

Recensentë: Behar Gjoka dhe Anna Kove

Korrektorë letrarë: Urim Bajrami dhe Edona Marku

Përkujdesja grafike: Elzana Agolli

Piktura në kopertinë: S. Esat, Shkup

ISBN 978-9928-327-41-3

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

Botimet TOENA

Rr. "M. Gjollesha", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: [redaksia@toena.com.al](mailto:redaksia@toena.com.al)

[botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)

[www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)



*B*isedat me të dhe, sidomos rrjedha e jetës së tij më kishin futur në një labirinth pa krye. Si një spirale e gjatë, e koklavitur dhe e pafundme vërtitej e rrotullohej në mendjen time gjithë ajo sagë e trishtë, ajo histori njerëzore që m'i zbehu të gjitha ngjarjet e tjera. Kjo sagë më cimbiste thellë në shpirt e po më trazonte pareshtur gjithnjë e më shumë. Një shtysë e brendshme më nxiste pandërprerë që ta shkruaja sa më parë, derisa m'u shndërrua në një maktë sipëror, që unë duhet ta kryeja patjetër.

Në sytë e mendjes më shfaqej herë pas here fytyra e tij fisnike, e plakur, e drobitur dhe me krahët e hollë që mbanin një tufë letrash në dorë. Ashtu i përkulur, më shumë nga dhimbja, sesa nga vitet, me rrjetën e rrudhave të lodhjes në duar e në fytyrë, qëndronte si një asket pranë oxhakut duke zgjedhur ngadalë fjalët ngashëryese, për të ma besuar brengën e tij; për t'u çliruar prej saj, në prag të udhëtimit drejt orientit të përjetshëm.

Përtej perdes së enigmës dhe misterit, që na ndante në ato çaste mua dhe atë, ai e mbaroi "rrefimin", duke ma lënë dramën e jetës si një kandil të ndezur me dritën e mpakur. Me të në dorë po vij drejt jush për të parë së bashku jetën e dy shpirtëve, që dashuria i bashkoi rastësisht dhe koha i ndau padrejtësisht.

*Gjatë shkrimit të kësaj historie, shpeshherë jam trembur se mos kandili që mbaja në duar mund të më shuhej nga erërat dhe furtunat e përditsshmërisë sime. Unë nuk isha prifti, që duhet ta mbaja të fshehur rrëfimin, por njeriu që kërkon vetveten, madje që ju kërkon juve. Sa më shumë ecja me këtë kandil drite në dorë, aq më thellë pashë brenda vetes sime rrathët danteskë, ku Antoni dhe Anja kishin feksur më parë.*

*Si një formë çlirimi nga guri, që më vari në qafë Antoni, fillova të radhis episodet e kësaj dashurie epike, edhe pse personazhet e mia kurrë nuk qenë “figura publike”. “Rrëfimet” e Antonit dhe letrat e Anjës i keni këtu siç m’i dhanë. Siç m’i besuan...*

*U bëra pak Anton, duke udhëtuar e vizituar të gjitha vendet, ku ai dhe Anja kishin ngjizur dashurinë surreale, për të parë, për të prekur, shënuar dhe vëzhguar nga afër gjithçka që lidhej, jo thjesht me tregimet e tij, por për të ndier shpirtin e tyre të shpërndarë në ngjyrat e vjeshhtës.*

*Nga atje, buzë liqenit të Drinasit, ku ndezi puthja e tyre, më vjen një zë thellësie, një pyetje qiellore: dashuri pa martesë apo martesë pa dashuri? Nga atje, nga “Fauburg Saint – Antoine, nr 184”, Paris, më vjen pyetja e Anjës: një dashuri e shkurtër me vuajtje të gjatë apo një martesë e gjatë pa vuajtje dashurie?*

*Autori*



## KREU I

**A**ntoni ishte një burrë në moshë të thyer, mu si koha kur e takova. Rrezatonte gjithmonë qetësinë dhe fisnikërinë e një shpirti prush të mbuluar me një tis hiri të vënë nga vitet mbi supe. Ecja e tij dhe bisedat me të rrethoheshin me një aureolë krenarie të përmbajtur... Sjellja dhe veprimet e tij ishin të matura, të kujdesshme, pa teprime, krejt njerëzore dhe të ngjallnin vetvetiu një simpati pa shkak për atë që kishe përballë. Me karakteristikat e një monumenti njerëzor ai binte lehtë në sy në ambientet e atij fshati të vogël ku po i vinte pika epilogut të jetës.

Ai kishte rreth tri vite që jetonte në fshatin me emër druri, - në fshatin Dushk, në periferi të kryeqytetit të stërmadh. Dushku kacavirrej dhe më pas shtrihej pllaja-pllaja jo shumë larg metropolit, në pjesën jugore të tij, duke lagur këmbët në lumin tinëzar. Ujërat e tij, pasi kalonin mes për mes fshatit, duke shtrirë krahët nëpër ara e kopshtije, zbrisnin teposhtë kodrave, drejt detit, që shihej shumë

bukur prej aty. Perëndimi i diellit i larë me argjend, mbrëmjeve e vishte lumin me ngjyrë ari dhe dukej si një llavë floriri që doje t'i zije pritën... Flladi i lehtë kalonte atypari, gjithnjë syçelur, për të ndalur fantazinë që përthyhej ngjyrash e dritash.

Se nga vinte ky njeri, ç'profesion kishte patur e çfarë kishte bërë në rininë e tij, askush nga banorët përreth nuk e dinte. Madje, atyre u pëlqente ashtu siç ishte, një enigmë njerëzore, mes atij peizazhi të magjishëm. Misteret ngjisin si myshqet nëpër anët e mureve të vjetra, ndaj dhe enigma që rrethonte këtë zotëri, e bënte më të vlefshëm për hamendësimet e banorëve përçark. Vetë ai nuk hapej në biseda me vendasit, të cilët i respektonte. Rrallë e shikojte të bisedonte me dikë për një kohë të gjatë. Kur dilte jashtë shtëpisë, përshëndeste këdo që i dilte përpara, sidomos fëmijët. Nga fytyra nuk i shqitej një buzëqeshje e mbushur me ngjyra, pasqyrë njerëzore e natyrës. Kur bashkëvendasit përpiqeshin të gërmonin me pyetje pa takt në bashkëbisedim me të, ai u vinte përballë si një shëmbëllim marramendës buzëqeshjen e tij elegante. Kjo nuk ishte një maskë, por një ftesë njerëzore për të shkuar larg, tepër larg, atje ku edhe më trimi, zor se do vraponte.

Çdo ditë, pasi bënte një shëtitje në kodrinat e gjelbëruara, ulej dhe pinte kafën e mëngjesit në barin e qendrës së fshatit, një ndërtesë e përdorur më parë si postë-telegrafa e fshatit, ku niseshin letrat e ku lidheshin me telefon banorët në periudhën e



komunizmit. Një nga djemtë emigrantë, thuhet se ishte ndër të parët, u kthye dhe e përshtati si kafene moderne, duke i vënë edhe emërtimin “Bar Vini”. Pas kafesë së zakonshme të “Bar Vini” ai kthehej e mbyllej në banesën e tij, rrethuar me gjelbërim e lule. Rehatohej, si në një kafaz me libra, me të cilat “fliste” pa zë. Lexonte, studionte gjithmonë, a thua se përgatitej për ndonjë provim final. Tek-tuk nëpër faqet e librave mund të gjeje hirin e shuar të cigares, të cilën s’e ndante nga buzët. Po t’ia shihje fjollat e tymit, dukej se rreth tij silleshin hije njerëzore të botës tjetër.

Herë pas here i vinin për vizita shokë dhe miq, krejt të panjohur për vendasit. Ata merrnin rrugën për ta takuar, për të biseduar dhe për t’u çmallur me të. Ishin njerëz në moshë të madhe, burra dhe gra, gjithnjë të veshur mirë. Kalonin orë me biseda brenda shtëpisë së tij, derisa ai dilte për t’i përcjellë deri te vendparkimi i makinave. Këtë “shfaqje”, prej së largu, komshinjtë e shihnin, kryesisht fundjavave.

Unë e njoha rastësisht. Herën e parë e takova rreth një vit më parë të “Vini”, në barin e fshatit. Pasi pimë kafe dhe, pas disa bisedave, m’u duk se po miqësoheshim me njëri-tjetrin, aq sa erdhi një kohë që, në fundjavë nuk shkonim të kafja pa njëri-tjetrin. Na pëlqente biseda që bënim kur ecnim një copë rrugë së bashku. Unë dukem më i lidhur me bimët dhe, atij i pëlqente kur kuvendoja me atë dhe u jepja jetë secilës prej tyre, duke i bërë gati njerëzore. E

habiste biseda dhe pasioni im për bimët, pemët dhe përkushtimi im në shërbim të tyre.

Një ditë më ftoi në shtëpinë e tij. Nuk pranova menjëherë, sepse e konsiderova si gjendje të momentit. Kur ai tha “kam edhe unë pyllin tim për të ta treguar”, fillimisht u stepa dhe e pashë në sy, se mos tallej. “Veçse unë, ato drurët e bukur, për të cilët më flet, i kam në formë librash. Domethënë, kam një pyll me libra. Kam kohë që dua të vish e të flasim mes tyre.” Atëherë, pranova dhe, të nesërmen, pasi pimë kafën e zakonshme, shkuam së bashku. Shtëpia, një dykatëshe e bukur që binte në sy nga shtëpitë e tjera, ndodhej jo më shumë se pesëqind metra larg barit.

Antoni, mbiemrin e të cilit nuk e kisha mësuar ende, sapo hymë brenda, më tha se e kishte pikasur vetë atë banesë dhe po vetë ishte “arkitekti” që kish vënë rregullin brenda dhe jashtë saj. Më pas, më shpjegoi se ajo ishte si një “kapsulë” urbane, për t’iu shmangur vorbullës së zhurmshme të kryeqytetit. Kuptohej, se ai ishte zhvendosur këtu për të kaluar vitet e fundit të jetës, në qetësinë e tij.

Sa herë e shikoja, kur nuk e kishte mendjen, më dukej gjithmonë i zhytur në të thella. Unë, nga distanca sikur e pyesja: “për çfarë po mediton? Çfarë po përtyp në atë mendjen enigmatike? I ke ide, kujtime, brenga apo ndodhi.” Hera-herës më dukej se ashtu bënte bilancin e jetës së vet, - vetë pesho e vetë shëno! Edhe unë, si të tjerët, kisha bërë të

njëjtat pyetje; nga vinte ky njeri? Çfarë profesioni kishte pasur dikur? Ç'familje kishte?!... Asgjë nga këto nuk mësova dot në takimet e para dhe bisedat e deriatëhershme me të. Mbase, pikërisht mungesa e kureshtjes sime, kishte shërbyer si çelës për të shkuar drejt strofullës së tij, të mbushur me libra dhe zbukurime arti. Edhe ditën e parë që u takuam, mbaj mend se bisedën e nisëm dhe e mbaruam për librin që mbante në dorë. Ishte një libër i një autori të huaj. Ai po shfrytëzonte dhe pushimin gjatë pirjes së kafesë së mëngjesit për të lexuar disa faqe. Pasi më shuajti kuriozitetin për atë libër dhe mësoi vlerësimin tim për librat, bisedat e tjera vijuan në këtë linjë.

Atë ditë, që ishte e shtunë, më ftoi ta shoqëroja për në banesën e tij. S'e di pse më ishte krijuar një ide e mistershme për ambientin ku jetonte. Ndaj me kuriozitet e dëshirë u ngrita e, duke biseduar me të, mbërritëm në pragun e shtëpisë.

- Hajde, - më tha, - urdhëro brenda!

Unë, si me ngurrim, kalova pragun dhe hyra. Ishte hera e parë që po e vizitoja strofën e tij. Një shtëpi e ndërtuar me shije, e lyer nga jashtë me ngjyrë qumështi dhe e mbuluar me tjegulla të kuqe. Me dritare të mëdha, të mbyllura me grila jeshile, dhe ballkone të bukura, ku varehin bimë kacavjerrëse të gjelbëruara. Në hollin e madh, në të djathtë, zura vendin që ma tregoi me dorë vetë Antoni. Ai mjedis në të gjitha anët e mureve ishte i mbushur me rafte

librash. Kishte shumë libra, thuajse në çdo hapësirë në mobiliet e rënda prej dërrase. Ndërmjet rafteve, zinin vend piktura, skulptura dhe foto që të yshtnin kërsërinë për t'i parë nga afër e për të mësuar rreth tyre. Këtë mund ta bënte vetëm i zoti i shtëpisë, i cili mund të shpjegonte domethënien dhe historinë e secilit objekt. Ai mund të tregonte arsyen e vendosjes dhe simbolikën që përfaqësonte çdo statujë, pikturë ose foto që kishte zënë vend aty. Domsodo, çdo objekt ishte i rëndësishëm për Antonin. Në të vërtetë secili kishte diçka të veçantë, një histori, një kujtim për ta treguar. Por ai nuk e kishte mendjen për ç'po mendoja dhe ç'dëshiroja unë. Isha një i njohur i ri dhe nuk kisha pse të drejtoja as pyetje dhe as të kërkvoja të shuaja kureshtjet brenda pak minutash. E vlerësoja që ai njeri më respektoi duke më ftuar në shtëpi. Ndoshta isha i vetmi nga banorët e atij fshati, që vizitoja banesën e tij. Nga banorët e atyshëm, me aq sa dija unë, asnjëri nuk kishte patur rastin ta vizitonte shtëpinë nga brenda. Për të gjithë që e njihnin banorin e ri, ai ishte një njeri i mirë, i respektuar, por enigmatik, i çuditshëm. Kishte dhe të tjerë banorë nga kryeqyteti, që kishin ardhur në këtë zonë ose kishin shtëpi të dytë aty, por Antoni ishte krejt ndryshe.

- Dëshiron një konjak? - më pyeti, ndërkohë që mbante në dorë një shishe të bukur qelqi me etiketë franceze. Atë e mori nga ambienti tjetër në të majtë, ku dukeshin pije të ndryshme, të vendosura në një

mobilitë të punuar enkas për të mbajtur shishet e verërave dhe pijeve alkoolike.

- Faleminderit, - i them, pse jo. Nëse dhe ju do pini një gotë...

- Sigurisht, - tha dhe u ul ngadalë përballë meje në poltronin e rëndë pranë oxhakut. Dukej që ai ishte vendi ku rrinte zakonisht, sepse edhe kish marrë formën e trupit të tij, nëse e sodisje më me kujdes.

Antoni ishte një burrë me trup të gjatë e të drejtë, pa bark. Dukej shumë elegant për moshën që kishte. Me portretin e ëmbël dhe simpatik, shprehte gjithnjë miqësi, pavarësisht se edhe mua, më dukej se përreth tij kishte një mjegull të pashpjegueshme. Pavarësisht nga mosha e madhe, rrudhat i kishin krijuar një mozaik të rregullt, si sinoret e arave dhe shtriheshin lirshëm kudo në ballë, në fytyrë e në gushë, pa ia prishur nurin e një mashkulli të hijshëm e fisnik. Kokën ia mbulonin flokët e thinjur, krejt të bardhë, me pak onde, por të shpeshtë e jo shumë të gjatë, duke i dhënë pamjen e një plaku hirplot, që më përngjasonte me aktorin Michael Douglas. Fytyrën e kishte të rruar dhe të pastër. Sa herë që e kisha parë, ai dukshëm tregonte një përkujdesje të madhe për higjienën dhe dukjen e tij. Të jepte përshtypjen e një ushtaraku në pension, i "stërvitur" për t'i kushtuar rëndësi çdo mëngjes përgatitjes së tij personale.

- Më quajnë Anton Hila, - tha, pasi ishte rehatuar në ndenjësen e tij të gjerë dhe të rëndë.

- Gëzuar dhe mirë se të gjeta, - zgjata gotën time drejt tij.

- Gëzuar dhe mirë se erdhe! Pak vonë, por.... Dhe heshti duke mbledhur pak buzët, sikur desh të thoshte “tani u gjend koha”. Pastaj shtoi:

- Siç mund ta kesh vënë re, nuk kam shumë kohë që kam ardhur të jetoj në këtë shtëpi. Zgjodha këtë vend, sepse kam nevojë për qetësi. Sidomos pleqëria ime ma kërkoi gjetjen e kësaj strofulle.

Më pa me dashamirësi, sikur kërkoi leje për të vazhduar dhe vijoi:

- Kisha një shtëpi të mirë në zonën qendrore të kryeqytetit, por erdhi një moment që nuk e përballoja dot zhurmën dhe rrëmujën me të cilën zgjohet herët metropoli. Dikur, rrugicat me potere më zgjonin dhe më përcillnin për në punë. Isha plot energji dhe nuk e përjashtoj që, në njëfarë mënyre, kam qenë edhe unë një prej atyre që e trazonin herët qytetin. Por erdhi një kohë që edhe nga përtej dritares sikur më hynin në dhomën time zërat, tingujt dhe vetë kaosi i shfrenuar, i asaj makine të madhe që ndizte motorët në pikë të mëngjesit dhe nuk i shuante as deri vonë në mesnatë. Ndaj erdha këtu dhe ndihem mirë, ndihem i qetë.

Fliste e tregonte, ndërkohë që mbante afër shishen për të rimbushur gotat. Shihte herë pas

here nga gotat dhe nga shishja, me qëllim që të mos mbetej bosh gota ime. Pastaj vazhdonte bisedën e më fliste duke më parë në sy. Ai, në fakt ishte për mua një tip i mistershëm, që më bënte kureshtar të dija të paktën se nga vinte dhe çfarë kishte qenë e diç të mësoja për të kaluarën e tij. Prej kohësh e lexonte kërshtërinë time dhe, si me pikatore, i nxirrte fjalët për veten. Në një moment u ndal dhe, duke vënë në fytyrë një hije kureshtjeje, m'u drejtua:

- Më fal, o Aleks, por as unë nuk ta mësova mbiemrin këto kohë. Po të isha në punë e të takoheshim në qytet, do të pyesja menjëherë, por këtu te kafja e "Vinit", mjafton vetëm emri.

- Kuka, Kuka, - përsërita unë dy herë mbiemrin tim, si për ta ndihmuar që ta fiksonte mirë në mendje.

- Çfarë angazhimi kryesor ke? Se në kohët e sotme, ndodh që të bësh edhe dy punë, se me një nuk ia del dot.

- Kam studiuar për gazetari, - i thashë, dhe punoj për gazetën "Meteor".

- Aha, shumë mirë. E kam lexuar "Meteorin", por tani jo.

Bëri një pauzë disa sekonda dhe plotësoi: - Unë kam studiuar për inxhinieri ndërtimi. Vazhdoi të tregonte pak për shkollën, miqtë e dikurshëm – inxhinierë dhe arkitektë me emër dhe herë pas here ngulte vështrimin në gotën e tij të gjerë, që e rrotullonte në mënyrë të njëtrajtshme me dorën e djathtë.

Ai, në fakt, më shumë ngjante me një studiues, shkrimtar e ku di unë se çfarë, sesa me një inxhinier të zakonshëm, të fiksuar mbi harta e vija. Madje, me këto fjalë të pakta për të kaluarën e tij, po më ngjasonte me ndonjë ish- agjent të shërbimit sekret, që ka frikë t'i hapet dera e së kaluarës së tij. Ata, në biseda me të tjerët, përpiqen të mbulojnë me terr udhëtimin e tyre të gjatë profesional dhe enigmatik. I lodhin gjërat e fshehta, që kanë bërë të diktuar nga natyra e punës së tyre dhe që vetëm ata i dinë. Ankthi për jetën e kaluar i ndjek kudo që shkojnë. Edhe në ëndrrat më të fshehta.

Duke parë me radhë, librat që na rrethonin, e pyeta:

- Anton, cili është libri më i bukur që keni lexuar?

Ia bëra këtë pyetje për të nxitur bisedën për librat, pasi e dija që i pëlqente të fliste për to. Fundja, edhe ftesa, shkas kishte librat - "pyllin" e tij të librave.

Më hodhi një vështrim të qetë dhe u përpoq të më jepte përshtypjen e një përgjigjeje të sinqertë:

- Në fakt, mik i dashur, librin më të bukur them se nuk e kam lexuar ende.

Më tha këto fjalë dhe e ktheu gati plotësisht gotën e tij, pothuajse të boshatisur nga konjaku. Kjo përgjigje ishte si për të thënë se, kërshëria e tij për librin s'do shteronte kurrë, sa të kishte jetën.

E filluam dhe e mbaruam bisedën atë ditë duke folur për librat dhe ngjarjet politike të ditës. Nuk



shfaqte pasion ndaj ndonjë force politike të caktuar, por kritikonte pa rezerva nisma e qëndrime të të gjitha palëve, që sipas tij, ishin populiste dhe jo efektive për shoqërinë.

Jetonte i vetëm në atë shtëpi, si një kryelibër! Ai kishte faqet e tij të fshehta, ku ndodheshin të radhitura mendimet, kujtimet, vizionet, ëndrrat, emrat, skicat, ndërtesat, rrugët, ujërat, pyjet, qielli, nata, hëna, dielli, yjet dhe gjithçka tjetër. Ai merrej me të gjitha këto në një mënyrë tipike, larg syrit dhe veshit të fqinjëve kureshtarë. Të gjitha librat që ndodheshin aty rrotull lexoheshin e kuptoheshin më lehtë, sesa libri që kishte brenda vetes; librin që as nuk shkruhej, as nuk përkthehej dot. Atë, mbase vetëm perëndia do ta shfletonte germë për germë, e rresht për rresht, pa gabime e pa shkëputje.

Që nga ajo ditë kur pimë konjak e folëm për librat, unë do të takohesha gati çdo fundjavë apo sa herë që vija në fshat. E takoja me dëshirë dhe kuriozitet. Por edhe ai e tregonte tashmë se mezi priste të rrinim bashkë. Këtë e kuptoja nga shakatë që bënte kur më shihte. Asnjëherë nuk përdorte të njëjtën batutë. Mesa duket, e kishte kohën të prodhonte gjithnjë një gjetje të re. Kohë pas kohe vija re se jo vitet, por javët dhe madje ditët po e thyenin si një lis që përkulet centimetër pas centimetri, duke u anuar në njërin krah, me gjithë degë e fole zogjsh nëpër të. Me gjithë përpjekjen dhe sforcimin që bënte kur ishte përballë meje, dukej qartë se duart

nuk i komandonte si dikur dhe i dridheshin. Vetëm kur lexonte diçka ose kur fliste me telefonin e tij përdorte një palë syze me skelet të hollë, shumë fin për fytyrën e një plaku, i cili mundahej që me lëvizjet e tij të ishte dinamik dhe mos të dukej aq i rrënuar. Donte të jepte gjithnjë përshtypjen e një zjarri plot prush të fshehur nga hiri. Dikë më kujtonte madje më ngjanin si dy pika uji... Po, tani u kujtova...

Kisha lexuar romanin “Plaku dhe deti” të E. Heminguej dhe, ditë pas dite, po më krijohej në kokë një histori paralele, që meritonte një titull tjetër: “Plaku dhe fshati”. Çfarë bënte Santiago i fshatit tonë në gjithë këtë det të gjelbër, në këtë vetmi dallgësh kodrinore? Nisur nga biblioteka shumë e pasur që kishte, ai dukej që udhëtonte përmes leximesh pafund. Kjo ishte diçka interesante, e bukur, natyrisht tekefundit, sikur edhe një jetë të merresh vetëm me leximin, sërish nuk mund të lexosh të gjitha librat që dëshiron vërtet. Ama për një njeri që i do librat, duke lexuar pa ndërprerje, ke ujitur pemën e madhe të shpirtit. Jeta e një njeriu që ka kohë, dëshirë dhe lexon vazhdimisht është e plotësuar më së miri. I adhuroj shumë njerëzit që lexojnë dhe e duan librin, Antonin diçka më shumë. Edhe pse nuk e lexonte më gazetën ku punoja unë. “Gazetën e lexojnë ata që shkojnë nesër në punë, por jo unë, që e kam nxjerrë punën në pension”, më tha një ditë, kur të dy vumë re që s’e kish prekur fare gazetën që lashë tek ai një javë më parë.

Po familjarët e tij a vinin ta shikonin ndonjëherë këtë njeri? A kishte vërtet të tillë? A kishte familje, grua, fëmijë, të afërm?

Që kur u njoha me të më mundonin këto pyetje, por nuk ishte tipi që të krijonte mundësi të merrje ndonjë shpjegim, pa dashur ai vetë. Tekefundit, përse duhej ta pyesja? Jeta e tjetrit është personale dhe është normale që ai të flasë vetë për të. Sigurisht që do e vija në siklet. Nuk i dihet, ndonjëherë mund ta vendosësh tjetrin në pozitë të vështirë me pyetje të tilla. Hollë-hollë, as mua nuk më pëlqen kur më bëjnë si pa teklif pyetje tejshpuese, që kërkojnë të nxjerr zorrët e barkut në tavolinë. Jo krejt si Antoni, por edhe mua nuk më pëlqen të më hyjnë në brendësinë time me ato shushunjat e pyetjeve që kërkojnë skutë më skutë ditët e mia, jetën time. Edhe ai, në fakt, nuk më kishte pyetur fare për gjërat e mia familjare.

Ai e rrotullonte bisedën vetëm rreth profesionit, rreth historive të punës të ndodhura vite më parë. Pastaj e përziente me opinionet politike, kulturore, historike dhe letrare. Citonte shpesh fraza të filozofëve të lashtë dhe tregonte përmbledhtazi subjekte të librave të shkrimtarëve klasikë, që i kishte më shumë për zemër. I kishte lexuar e rilexuar gjatë gjithë jetës së tij, aq sa hera-herës merrte poza si Uilliam Folkner, pa e ditur as ai vetë.

Mund të them se e kisha krijuar njëfarë miqësie me Antonin. Vija re se sa herë që shkoja në fshat,

ai me dëshirë i priste bisedat me mua. “Kam nevojë për ngjarje të freskëta, si kuzhinieri për perimet e sapokëputura”, - më cyste mua të zbrazja xhepat e historive jozyrtare të kryeqytetit. Pastaj, kalonim te diskutimet dhe bisedat tona të zakonshme, që ishin larg tringëllimës së përditshmërisë kryeqytetase. E ndieja që kisha fituar respektin e tij, ndonëse, nuk donte ta shprehte hapur këtë. Kjo më gëzonte, pasi dhe unë sa vija në Dushk, mezi prisja ta takoja këtë mik të mirë. Thirrjet e tij u bënë më të shpeshta dhe bisedat me të u bënë gjithnjë e më të gjata.

Më tregoi një ditë se, gjatë jetës kishte kryer detyra të larta në dikastere të rëndësishme të shtetit. Pas mbarimit të studimeve inxhinierike në Tiranë, për dy vite kishte studiuar në Çeki, në fushën e inxhinierisë së ndërtimit e konstruksionit. Ky kualifikim dhe përkushtimi në punë, e kishin vënë në ballë të punëve me përgjegjësi të lartë, derisa ishte larguar vetë nga sistemi shtetëror për t’u angazhuar në një kompani ndërtimi. Nga të parët e tij, gjyshi dhe gjyshja që ishin lindur në kryeqytet në kohën e Mbretërisë, kishte trashëguar prona. Por dhe nga të ardhurat e veprimtarisë së tij kishte krijuar një buxhet normal, që të mos e vriste shumë mendjen për një jetesë të mirë. Nuk i mungonte asgjë.

Më tregoi se nuk ishte martuar kurrë dhe nuk kishte fëmijë. Këtë nuk e tregonte si peng të jetës së tij, por si diçka, që ai nuk e kishte dëshiruar vetë.

Nuk pendohej për këtë. Me sa duket ishte nga ato “libra” që nuk i kishte lexuar deri në fund...

Antoni, në vitet e regjimit komunist, kishte patur fatin që, si student i shkëlqyer i inxhinierisë së ndërtimit dhe me “biografi të mirë politike”, ta “meritonte” besimin e partisë për atë specializimin dyvjeçar në Pragë. Kur tregonte ndonjë histori me Pragën, ndonjëri e pyeste për saktësim: në Pargë? Jo mo, jo, në Pragë, - saktësonte Antoni.

Pasi ishte kthyer nga Praga, ishte angazhuar në Ministrinë e Ndërtimit, fillimisht si specialist e më pas si drejtues i lartë. Paralelisht jepte mësim në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, duke qenë kontribues shkencor në fushën e studimeve.

Pas ndryshimit të regjimit, Antoni qëndroi larg partive politike, pavarësisht se qeveritë e vlerësonin dhe trajtonin si teknikien dhe menaxher i vlefshëm për dijet, përvojën dhe njohuritë në fushën e ndërtimit dhe planifikimit urban.

Pas largimit nga institucionet shtetërore, ai kishte drejtuar për disa vite një kompani private ndërtimi nga më të mëdhatë në vend. Gjithmonë kishte qenë në rrethin e njerëzve me reputacion të lartë, në elitën e kryeqytetit.

Në rininë e tij, si djalë i kulturuar dhe bukurosh, aventurat e dashurisë me vajza të bukura ishin një pjesë romantike e jetës, ku drama dhe melodrama nuk kuptoheshin si gjini letrare, por si realitete pagjumësie të bukur.

Siç më tregonte një buzëmbërme, vetëm një herë kishte dashur të fejohej e të martohej me të vërtetë. Ajo kishte qenë vajza e një aktori të famshëm në vend. Eli quhej. Studionte për Fizikë. Flitej se kishte qenë një nga vajzat më të bukura në Fakultetin e Shkencave në atë kohë. Të dy dashuroheshin marrëzisht. Një lidhje e fshehtë, por e zjarrtë. Kur kjo marrëdhënie u bë e ditur në familjet e secilit, prindërit eELIT refuzuan kategorikisht. Kjo marrëdhënie pra, nuk kishte vajtur për mbarë, sipas ëndrrave të tyre. Prindërit e Elizës nuk dëshironin kurrsesi që kjo lidhje të qëndronte në këmbë. Dashuria e tyre zgjati jo më shumë se gjashtë muaj. Një dashuri e pastër, e singertë, e bukur, e vrullshme e plot ëndrra dhe plane për të ardhmen e dy të rinjve. Elit ia ndërprente prindërit vitin shkollor, vetëm e vetëm që ajo fejesë të mos bëhej. Dy të rinjtë e kishin përjetuar shumë keq diktatin prindëror të kësaj ndarjeje. Shpata e hekurt e shkëputjes së marrëdhënies së tyre kish zbritur si gjysmëhënë e ftohtë duke hyrë mes tyre, duke lënë pas një nga traumat më të mëdha të jetës së tyre rinore. Antoni mendonte dhe pati vendosur brenda vetes që të mos provonte më martesë me një femër tjetër. Këtë ia kishte deklaruar solemnishtELIT, ditën që e takoi për herën e fundit. Edhe Eli i kishte deklaruar të njëjtën gjë. Këtë pakt vendosën dy të rinjtë në atë kohë të largët, e cila ndriçohet sapo e rikthen aty prozhektorin e kujtimeve. Nuk u takuan më kurrë. Nuk u panë më. As rastësisht.

Ndonëse histori të tjera dashurie kishin pasuar për vite, por asnjëherë ai nuk e prishi paktin me veten. As atëherë kur ndonjëra nga vajzat me të cilat krijonte një lloj partneriteti i kërkonte martesë. Edhe Eli, e dashura e tij e zemrës, nga sa kishte dëgjuar Antoni, nuk ishte martuar, derisa në udhëkryqet e fatit, thuhet se zgjodhi një të huaj. Ajo u dërgua me studime jashtë dhe kishte vazhduar jetën jashtë vendit. Ata, në këtë mënyrë, kishin mbetur peng i fatit ters të njëri-tjetrit. Vitet kalonin e secili prej tyre udhëtonte me pasaportën e vet shpirtërore.

Pas ndryshimeve politike që ndodhën në vend, kur regjimi komunist kishte rënë, Antoni mësoi me saktësi se Eli kishte shkuar në Amerikë. Pikërisht atje që martuar dhe kishte ndërtuar familje. Ky lajm edhe e gëzoi Antonin. Ajo kishte shfrytëzuar mundësinë të bënte zgjedhjen për jetën, ndaj Antoni nuk mund të ndihej fajtor për të. Nuk duhej që ajo, falë një pasioni të rinisë së tyre të hershme, të mbetej me vullnet një murgeshë. Ajo tashmë nuk ishte peng i asaj dashurie të hershme, peng i një betimi rinor, kur më shumë kishte folur zemra, sesa mendja. Kjo, pra, sikur e kishte çliruar Antonin nga një histori e shkuar, që e mundonte si ndonjë kollë kronike.

Kur burrat ngjiten në mesin e malit të moshës, që për më optimistët konsiderohet mosha 50-vjeçare, ndërmarrja e një lidhjeje serioze dhe afatgjatë me një femër, duket si një ftesë për ecje alpine. Kur Antoni po afrohej afër këtij kufiri, ia thoshte vetes

se tashmë nuk kishte energji, kohë e mundësi për ndonjë aventurë dashurie. Në përditshmërinë e tij, rrallë e te ndodhte ndonjë “aksident erotik”, pa pasoja në “paketën elektronike” të shpirtit dhe as në funksionimin e përgjithshëm të motorit; - maksimumi “thyerje pasqyrash”, kujtonte ai perifrashimin e një kolegu në moshën afër pensionit.

Ai jetonte në një shoqëri të zgjedhur dhe ishte i kënaqur në marrëdhënien mes tyre. Netët e vona tashmë i kalonte në shtëpinë e tij, krejt i vetmuar. Prindërit nuk i jetonin më. E kishin lënë prej vitesh. Në fillim babai dhe më pas nëna qenë larguar “si dielli me hënë”, kujtonte shpesh Antoni. Pas largimit të tyre, vetmia ishte një “shoqe” e përditnatshme që nuk ndahej prej tij, si një mur i padukshëm, në të cilin nuk mund të depërtonte kushdo. Prindërit e lanë me “gjitha të mirat”, siç thanë ata që morën pjesë në të dyja ceremonitë mortore. Por e gjithë trashëgimia, për djalin e tyre të vetëm, nuk e kompensonte mungesën e tyre, ikjen e papritur, largimin pa një valle dasme të të birit, pa përkëdhelitë e nipërve e mbesave, pa “ankesat” për punët gjysmake të nuses së djalit dhe pa dollitë e miqësive të reja. Ikën të etur për dollinë e dasmës.

Tani që pleqëria po i sillej rreth trupit të drobitur si një dhelprë bishtgjatë dhe hileqare në katrorin e apartamentit në kryeqytet, vendosi të largohet dhe ta bëjë “betejën” me pleqërinë dhelprake në fushë të hapur, atje te vila modeste në fshatin Dushk, në



periferi, jo shumë larg kryeqytetit. Nuk pajtohej me monotoninë e zakonshme të mbështjelljes së përditshme me fijen e hollë të pleqërisë si pezhishka, por donte të udhëtonte drejt fundit biologjik si një flutur - mbret (lat. *danaus plexippus*). Ajo lloj fluturë e kish marrë emrin nga njëri prej djemve të Zeusit të Olimpikut, prandaj edhe Antoni, atje, në majë të kodrës së fshatit, krijonte paralelen olimpikë të fundjetës së tij. Ai do të ishte mbi-flutur, që do të sillej rrotull e rrotull, degë më degë e lule më lule, prag më prag e cep më cep dhe pastaj, do të tretej bashkë me perëndimin e bukur të një mbrëmjeje fshati. Në qytet, fluturat i përcëllon betoni, asfalti, xhami dhe i bën pis pluhuri dhe zhurma e njerëzve. Pastaj, kur e mendonte, bashkëmoshatarët e tij në kryeqytet, ishin rralluar e tretur nga kjo botë. Kjo e ligështonte dhe e nxiste të mendonte pavullnetshëm për mënyrën se si ta priste fundin e tij, që kërkonte disa “para-përgatitje” enigmatike, një kurajo prej salmoni që bën mijëra milje në oqean, derisa kthehet për të pushuar në amshim, pikërisht te bregu ku e nisi jetën.

Tashmë kujtimet i riktheheshin më të shpeshta dhe ato e freskonin, e rigjeneronin së brendshmi, i gumëzhnin si koshere blete, që në fund i jepnin një grusht mjaltë, një grusht ëmbëlsirë, një shpresë për nesër. Mbrëmjet i kalonte si filmat me metrazh të shkurtër, bashkë me të gjitha historitë e kaluara dhe me personazhet gjurmëlënëse, herë me emër e

herë pa emër. Aq kilometra shirit filmi kujtimesh kishte në kokë, sa herë i dukej sikur kishte jetuar qindra vjet dhe herë-herë sikur kishte lindur dje. Kjo e shtynte të vriste mendjen për të kërkuar një lidhje astro-biologjike mes jetëgjatësisë së njeriut dhe jetëgjatësisë së një rrezeje drite që nisët nga një yll diku në galaktikë dhe arrin në pikën e fundit të mbërritjes në një kohë të caktuar. “Vite dritë”, belbëzonte me vete dhe shtonte “vite jetë”. Sa vite jete janë një vit drite dhe sa vite drite janë një vit jete? Në këtë udhëtim astral, përhumbej shpesh dhe, këto ishin momentet që ai “fluturonte” drejt gjumit të përnatshëm.

Ata që e njihnin thonin se është natyrë zemërmirë dhe që mendohej të mos i bënte keq askujt. Kur kujtonte ndonjë prapësi që s’duhej ta kishte bërë, mendohej ta hiqte nga mendja, ta harronte.

Bilancin e një jete e kishte të vështirë për ta bërë, sepse siç thoshte rëndom, “në jetë ndihesh i humbur me gjërat që ke bërë dhe ato që nuk ke mundur t’i bësh dot”. E tillë është krijuar natyra njerëzore me ëndrrat, fatet, me arritjen, pengjet, me ngjijtjet e zbritjet e veta. Antoni, ndihesh i mbushur dhe i plotësuar me jetën e tij. Të paktën, ashtu e vlerësonte ai. “Bilancin që ia bën vetes, or mik, nuk ta bën dot as prindi as fëmija”, më filozofonte ndonjëherë. Fati nuk e kishte gremisur pa mëshirë, siç u kishte ndodhur disa të njohurve të tij, me sëmundje, burgje apo tragjedi. Edhe kur ishte afruar në buzën e ndonjë

honi, një dorë e fshehtë e së panjohurës që zgjatur për të mbajtur, për ta tërhequr drejt shpëtimit.

Në “ripërtpjen” e kohës së shkuar parapëlqente të kujtonte shpesh udhëtimet e dikurshme, sepse ato ishin një pjesë e jetës që kishte dëshirë ta përsëriste edhe në përditshmërinë e dikurshme të profesionit apo të kohës së lirë. Udhëtimet ishin një nga pasionet e tij, që e frymëzonin dhe ushqenin shpirtërisht. Kishte udhëtuar në shumë vende të ndryshme të botës, nga ku ruante një dizinë me shënime, fotografi, harta dhe suvenire simbolike.

Prej motesh nuk ndërmernte më udhëtime të shpeshta, sidomos të largëta. Nuk kishte besim më te vetja, te shëndeti, që dita-ditës po bëhej më i dobët. Problemi më i madh tani sillej rreth sfidës “gravitacionale” të vendosjes në ekuilibër të kokës dhe trupit. Ndërsa për qafën e holluar, zor të gjeje jastëkun e përshtatshëm. Një kokë e parehatuar është torturë për trupin e lodhur. Gjunjët i lodheshin shpejt dhe marramendja shfaqej papritur, sa për të të trembur planet afatgjata dhe për të të shkurtuar destinacionet e largëta.

Me kujtimet e udhëtimeve të dikurshme, mbushte shëtitjet atje lart në fshat, tek ecte nëpër rrugicat e rrethuara me gjelbërim, nën një qiell të pastër e të plotë, që i rrinte si kapelë vere mbi kokë. Ecte në ajrin e freskët e, pasi bënte shëtitjet e tij të përditshme, ulej te bari i fshatit për ndonjë kafe. Rrallë zbriste në qytet.

Një grua nga fshati ishte pajtuar prej tij dhe paguhej rregullisht për t'i bërë gatimin dhe mirëmbajtjen e shtëpisë. Ajo kujdesej për gjelbërimin, si dhe i kujtonte marrjen e ilaçeve dhe kontrollin e tensionit. Me bashkëshortin e saj, shpesh bënë edhe ndonjë lojë domino apo shah.

Në orët e mëngjesit, kur dilte e bënte ecjen e zakonshme dhe pinte kafën me pak sheqer, “zonja sanitare”, siç e quante Antoni, sistemonte shtëpinë dhe i përgatiste ushqimin e ditës. Kjo jetë që po bënte, kish nisur t'i pëlqente jo vetëm për ambientin e gjelbër dhe plot oksigjen, por edhe për atë që tashmë, nis e mbaro mendonte vetëm për veten dhe nuk hapërdahej si shumë të tjerë mal më mal e kodër më kodër, qytet më qytet e shtet më shtet, duke pyetur se ç'bëri djali e ç'bëri vajza, ç'bëri nipi e ku shkoi mbesa. Gjithë sa kishte, ndodhej brenda asaj lëkure të rreshkur e të rrudhur...

Nga dreka mbyllej në shtëpi, dilte pasdite vonë. Lexonte libra, dëgjonte muzikë të zgjedhur dhe shikonte e rishikonte filmat më të pëlqyer. Te nostalgjia e filmave rishikonte kohën që nuk kthehej më, qytetet që kishin ndryshuar. Dy gjëra nuk kishin mundur të ndryshonin teknologjitë në filmat e rinj nga ato të vjetrit: dashurinë dhe urrejtjen.

Vetëm përdimin e diellit nuk harronte asnjëherë ta shijonte çdo darkë nga bahçja e tij. E sodiste diellin që rrokullisej pas kodrave dhe ndonjëherë zgjaste dorën ngadalë, dhe bënte sikur

po i jepte një të shtyrë të vogël ose sikur e mbante të mos fikej shpejt në fundin e padukshëm të detit. E shijonte përcjelljen e ditës dhe i gëzohej që edhe ajo ditë e la në këmbë, në formë të mirë për jetën e një plaku, në muzgun e tij për të pritur agimin e ditës së re.

Gjatë jetës ai e kishte pirë alkoolin, por me karar dhe gjithmonë pije të zgjedhura. Pinte verë gjatë ushqimit e pastaj “shtrohej” me uiski. Gradualisht ishte shkëputur nga pija e tashmë në të rrallë e përdorte alkoolin. Kurrësi nuk mundej të përballonte tavolinat që zgjasnin me orë të tëra si dikur, me miq, që pinin e pinin së bashku pa kufi. I kujtoheshin shpesh festat e zjarrta të dikurshme me miqtë dhe mikeshat e rinisë së tij. Ai edhe ishte dehur, mund të kishte bërë dhe prapësira dhe të nesërmen shmangej, nuk dilte. Nuk mbante mend ku kishte qenë dhe se ku duhej të kërkonte falje për ndonjë prapësi që nuk e risillte dot kthjellët në mendjen e drobitur. Makthi për kërkimfalje më shumë i bëhej si fiksion, pasi kurrë nuk kishte shkaktuar aq dëme sa të lëndohej dikush në tavolinë apo diku tjetër rrugës për në shtëpi.

Tomin dhe Sandrin, dy miqtë e vjetër, i takonte rrallë e më rrallë, sepse edhe ata ishin të pamundur nga mosha e thyer për të lëvizur lart e poshtë. Ishin dy miqtë e tij të jetës. Të dy juristë, që kishin mbyllur karrierat dhe tani po shijonin vitet e pensionit. I kishte patur dhe shokë të lagjes së tij, aty ku qenë

rritur, por dhe shokë shkolle, derisa secili ndoqi studimet e larta në korpuse të ndryshme. Miqësia e tyre kishte qenë e pastër dhe e gjallë, pa ftohje dhe ngrica në mes, pa pauza dhe vite bosh. Jetonin me njëri-tjetrin në një mjedis rinor pa fshehur asgjë, pa sekrete jete. Gjithçka dinin për sho-shoqin dhe brenda këtij trekëndëshi miqësie qarkullonin të gjitha “sekretet”. Kur bëheshin bashkë, i kujtonin njëri-tjetrit të gjitha ndodhitë e kaluara dhe vinin syrin larg për “prapësitë” e radhës, edhe pse nuk realizoheshin të gjitha. Sa herë takoheshin, sidomos kur u rritën dhe vraponin pas punës e profesionit, qeshnin me budallallëqet e moshës. Ato kishin mbetur vetëm në memorien tyre si trille rinore, të arkivuara në kujtesën e së shkuarës. Ata e dinin se e kaluara nuk përsëritej, nuk kthehej mbrapsht asnjëherë. Me ritmet që bëhej jeta tashmë, ato ndodhi dukeshin si filma të realizuar në një kohë tjetër, në një vend tjetër, nga njerëz të tjerë. Këta nuk ishin më aktorët, por spektatorë që argëtoheshin me ato ngjarje të largëta, sa herë uleshin dhe flisnin për to.

Një ditë prej ditësh, Tomi po u rikujtonte historinë e divorcit të tij, një nga ngjarjet më dramatike të jetës së tij. Por me “ndihmën” e miqve, ishte përmbyllur e gjithë saga e kujtimit me një hare që nuk donin ta linin Tomin në llucën e vuajtjeve shpirtërore. Ata e tërhoqën “zvarrë” me dollitë për të dhe hareja i vuri kapak çdo kthimi koke pas. Tomi, siç

merret me mend në këso rastesh, nisi e po u tregonte me shumë pezm, i tronditur dhe i nervozuar se, që prej asaj dite mund të listohej lirisht si një burrë i divorcuar. Vilma nuk do të ishte më bashkëshortja e tij. Të tre miqtë kishin filluar të pinin nga një gotë për ta tejkaluar dhe përballuar mërzinë e Tomit, por në fakt, ajo mbrëmje u ishte shndërruar në një natë të qeshurash pa fund.

Antoni e ngushëllonte se përse ishte martuar, jo pse ishte ndarë. Ai, si zakonisht e quante një gabim të madh martesën. E mbronte këtë teori, pasi ishte vetë një beqar i përjetshëm. “Nuk e them pse unë vetë jam beqar antik, por sinqerisht besoj në këtë që e them”, përsëriste shpesh Antoni. Ai e vlerësonte shumë lirshmërinë e një burri të palidhur me litarët e fjalëve të gruas në vesh apo shkelmat emocionale që kishte parë se si gratë e “dashura” ua japin burrave drejt e në surrat. E kur shikonte divorcet dhe përjetimet e tyre, Antoni vetëjustifikohej që nuk u kishte hyrë këtyre sikleteve... Tomit, me këtë rast, i perifrazoi Friedrich Nietzsche (Niçen) që, sipas tij, thoshte: “Të gjitha neurozat fillojnë në shtratin bashkëshortor”. Ai e kishte bindje të vetën tashmë atë që kishte thënë filozofi se, “kur martesë rrethohet nga dyshimet, vëzhgimet dhe xhelozia e sëmurë, të skllavëron shpirtin”.



## KREU II

*R*eth njëzet vite më parë.

Kishte rregulluar gjithçka brenda shtëpisë dhe, me çantën e mbushur me gjërat e domosdoshme, hedhur krahëve bëri të dilte. U step dhe një herë te pragu nga vetëtima e dyshimit të harresës së ndonjë gjëje që duhej marrë me vete ose duhej sistemuar në hapësirën që po linte pas krahëve. U kujtua edhe një herë për të gjitha gjërat një e nga një, duke qëndruar i dyzuar në këmbë, me dorën e vendosur në dorezën e derës, por pa e hapur atë. Do ta linte të shkretë apartamentin e tij për një kohë të gjatë. Prej shumë kohësh nuk qe larguar kaq gjatë me shërbim larg qytetit gumëzhitës, për t'i qëndruar në krye zbatimit të një projekti të madh hidroenergjetik, ku ai do të luante një nga rolet kryesore.

Me ndjenjën që diçka të rëndësishme kishte harruar pa e futur në çantën e tij, mbylli derën e apartamentit dhe zbriti në sheshpushimin e pallatit. Ishte qetësi dhe nuk kishte lëvizje në atë kohë. Ishte mëngjes herët. U drejtua me bagazhin e rëndë në



krah drejt vendit ku ishte parkuar makina e tij. Sistemoi në bagazhin e makinës çantën e madhe, pastaj vendosi laptopin në sediljen e pasme dhe hipi në makinën e tij të tipit “Toyota” fuoristradë me ngjyrë të zezë, në gjendje shumë të mirë. U rehatua në sediljen e tij, ndezi një cigare “Marlboro” dhe me mend po bënte dhe një herë inventarin e gjërave që në mbremje i kishte sistemuar për t’i marrë me vete. Kutinë e tualetit me të gjitha pajisjet i kishte të vendosura në vendin e veçantë. Ato nuk i harronte asnjëherë. Aparatin fotografik me disa filma rezervë e kishte futur në xhepin e jashtëm të bagazhit si gjithmonë. Kostumet, xhinset, peshqirët, të brendshmet dhe trikot po ashtu. U përkul para në sedilje, i mbështetur në timon dhe hoqi xhupin. E kaloi të palosur në sediljen e pasme.

Xhinset e zeza, një palë këpucë vjeshte të markës “Timberland” ngjyrë kafe, një bluzë e bardhë dhe xhupi meshin me ngjyrë të zezë, të vendosur tashmë në sediljen e pasme sipër laptopit, përbënin “arsenalin” e garderobës lëvizëse të Antonit. Syzet e diellit të markës “Persol” i palosi me kujdes dhe i vendosi në kutinë e makinës, që ishte sipër ballit të tij, në tavanin e makinës, një fole e bërë enkas nga fabrika për mbajtjen e syzeve. Nuk qe nevoja t’i përdorte shumë atë ditë, sepse edhe moti ishte pak i vrenjtur atë mëngjes vjeshte.

Ora ishte gjashtë e pesëdhjetë minuta kur ndezi makinën dhe nisi të ecte ngadalë në rrugicat mes

pallateve për të dalë në rrugën kryesore. Antoni do të duhej të udhëtonte gati gjithë ditën, për të mbërritur në qytetin e largët të Drinasit, ku do vendosej për një kohë të gjatë. Ai nuk e kishte me ngut. Atë ditë ia kishte kushtuar vetëm rrugëtimit dhe kjo e bënte më relaksues atë fillim dite.

Rrugës për në Drinas, Antoni bënte shumë kujdes në ecje, por syrin e brendshëm të mendjes, e qarkullonte hera-herës në pyllin e kujtimeve, përfytyrimeve dhe vizioneve për të nesërmen. Ishte vjeshtë dhe ky rrugëtim po i shijonte shumë, sidomos me ato peizazhe të mahnitshme plot me ngjyra, që stina u kishte dhënë maleve e kodrave, që po përshkonte me makinën e tij. Lugina dredharake e lumit, nga kalonte rruga për të mbërritur në qytetin e largët, ishte një kartolinë më vete, një pamje magjike, copë e vjedhur nga kopshti i Edenit.

Ai po shkante në atë qytet të largët për të drejtuar punimet e një projekti të një kompanie ndërkombëtare, e cila do të ndërtonte këtë vepër hidrike dhe kishte përzgjedhur Antonin si një inxhinier me përvojë dhe i zoti, për të ndjekur mbikëqyrjen e punimeve. Natyrisht, ai nuk do të paguhej sa homologu norvegjez, që do të bënte më pak punë e do të merrte më shumë shpërblim financiar. Krahasuar me disa punë të tjera të ngjashme, gjithsesi, kontrata e firmosur, i ofronte Antonit një “dinjitet” financiar më të mirë. Edhe kompania, edhe Antoni, ishin të kënaqur me njëritjetrin nga kontrata e nënshkruar një muaj më parë.

Kur u përpiluan kushtet e rëna dakord dhe u firmos kontrata, dukej qartë që të dy palët ishin dakordësuar me detyrimet për njëri-tjetrin, pasi kushtet ishin të kënaqshme dhe të favorshme.

Punimet infrastrukturore dhe deri diku logjistike, për ndërtimin e hidrocentralit në Drinas kishin filluar. Punët fillestare, kishin të bënin me ngritjen e godinave provizore dhe sistemimin e ambienteve të përshtatshme për stafet e punonjësit e plot hollësi të tjera që duheshin përgatitur, derisa kantieri të merrte formën e plotë.

Antoni kishte shumë vite pa shkuar në atë qytet. Tashmë që ishte në rrugëtimin e parë, në rrugën e re, për të vajtur në Drinas po i kujtoheshin vitet e shkuara në kohën e diktaturës, kur kalonte andej me shërbimet e dikurshme të dikasterit ku punonte. I kujtoheshin makinat, me të cilat udhëtonte atëherë, makina të vjetra të prodhimit rus dhe pastaj të prodhimit kinez. Iu kujtua barsoleta e treguar nga një miku i tij dhe filloi të qeshte me vete. Fabula lidhej me pyetje-përgjigjen mes dy qytetarëve, në kohën e komunizmit :

- Cila është makinë më e mirë, “Benzi” gjerman apo “Zisi” rus?

- “Zisi” rus, - ishte përgjigjur menjëherë bashkëbiseduesi.

- Ohu, ti nuk e paske idenë fare, nuk i njihke makinat!

- Jo! Unë i njoh shumë mire makinat, por nuk të njoh ty, - ia kishte kthyer përgjigjen tjetri.

Antoni, që e kishte jetuar kohën e komunizmit, i shkaktonte të qeshura ky dialog anekdotik, pasi nëse këtë pyetje ta bënte një provokator dhe tregoheshe i sinqertë në përgjigje, mund të përfundojë në burg si një njeri që pëlqen më shumë mallrat e kapitalizmit se ato të socializmit.

Rruga e vjetër ishte me kthesa të forta e të thyera, që ngjitej e zbriste malet e pafundme, pa pushuar fare; një rrugë shumë e gjatë dhe e lodhshme. Tashmë rruga e re, e bërë para pak vitesh, përshkonte luginën e lumit në një trajektore të drejtë. Ngjante me një udhëtim panoramik tridimensional, plot ngyra dhe jetë, krahas xhadesë së vjetër, të rrjepur copa-copa, si lëkurë gjarpri e braktisur. Rruga e re e kishte shkurtuar mjaft distancën. Pas rënies së komunizmit, kohët kishin ndryshuar dhe gjithçka ishte përmirësuar. Dhe njerëzit mendonin ndryshe tashmë, ushqeheshin ndryshe, dhe pritshmëritë i kishin të ndryshme, në krahasim me atë kohë që mbyllej si guacka e një stine dimri.

Peizazhet në përgjithësi, por sidomos vjeshta mbetej e preferuara e Antonit, ndaj dhe herë pas here ndalonte e shijonte me kërshtëri natyrën. Shikonte gjethet e derdhura në kodrinat ndanë rrugës e pastaj sodiste pemët, që akoma nuk i ishin dorëzuar vjeshtës, sepse gjethet e tyre akoma nuk ishin ngjyrosur plotësisht. Zgjidhte panorama

të bukura dhe me aparatën e tij fotografik të tipit “Sony” fiksonte detaje dhe copëza nga peizazhet e gjalla të stinës. Ngjyrat e ndryshme dhe larmia e formave e intrigonin për të qenë më i dashuruar me çuditë e natyrës, me ndryshimin dhe ciklin që pësonte bimësia. Bimët e pemët, ashtu si njerëzit, kishin ciklin e vet të zhvillimit. Secili pësonte ndryshimin e vet dhe kishte fundin e tij biologjik. Dhe njeriu përjeton stinët e veta derisa në fund, edhe ai rikthehet në gjirin e natyrës. Cikël i ndërthurur çuditshëm!

Antoni ishte fëmijë i vetëm. Prindërit nuk i jetonin më. Kushërinjtë e tij i kishte në veri, në alpe. Vetëm një herë i kishte vizituar, këtu e 30 vite të shkuara. Edhe babai i kishte lindur në kryeqytet, kështu që lidhjet me njerëzit atje ishin krejt të zbehta.

Mbante mend nga ai udhëtim i hershëm bukurinë e bjeshkëve, pastërtinë e natyrës dhe i kujtohej se si i dukej vetja kur ndodhej aq afër me qiellin. Gjithmonë i sillte në mendje kreshtat e larta, kullat shekullore me frëngji, ndërtuar me gurë të gdhendur. Emri i fshatit quhej Saukull. Nuk e kishte deshifruar dot atë emër nga e kishte prejardhjen, por i bënte përshtypje fjala kullë në përbërje të tij dhe kaq. Kujtonte ndonjëherë farefisën e tij me sa mbante mend ato ditë që kishte kaluar atje. Ishin njerëz me tipare të bukura. Njerëz të varfër, por me norma tradicionale. Gjatësinë e trupit dhe fytyrën

e tij e kishte pikërisht nga origjina e të parëve. Kështu i kishte thënë babai dhe kjo i ishte fiksuar që atëherë në mendje Antonit. Vetëm tiparet fizike dhe krenaria i kishte mbetur nga babai e nga gjyshi, se të gjitha të tjerat qenë zbehur tek Antoni.

Duke u rritur në ambient qyteti, në shkolla e në shoqëri universitare e akademike kishte fituar maturinë, qetësinë dhe elegancën në sjelljen e tij. Ishte tolerant dhe i dëgjueshëm, cilësi që nuk spikasnin shumë në mjedisin tradicional nga vinin të parët e tij. Thuhej se ata ishin shpërthyes dhe hakmarrës.

Në fshatin e të parëve të tij, në Saukull, Antoni kishte kaluar dy javë pushime verore. Asokohe po mbushte gati njëzet vjeç dhe sapo kishte mbaruar vitin e dytë të studimeve të larta. Në atë fundgushti kishte ardhur me babain e tij për të kaluar ato ditë. Përveç natyrës së bukur alpine, atij i kishin mbetur në kujtesë shumë gjëra që i ishin përforcuar pastaj në kohën nga bisedat e kujtimet me babain. I shtyrë nga këto biseda, kurioziteti e kishte nxitur për të lexuar ç'të mundte për traditën dhe historinë e të parëve. Ato ditë ndihmuan të materializoheshin tek Antoni gjithçka që lidhej me traditën dhe historinë e paraardhësve të tij.

Antoni kishte fiksuar gjithçka, çdo detaj, që babai i tij ia kishte ngulitur në mendje. Ai nuk i harronte kurrë ato biseda, që kishin në themel mënyrën e organizimit dhe funksionimit të kullës

shqiptare dhe banorëve të saj në malësi. Aty ai kishte mësuar, se sa rëndësi ka fjala e dhënë, sa domethënëse janë marrëdhëniet mes vëllezërve në familjen tradicionale. Më vonë, këto Antoni do t'i haste në kornizat e kanuneve të ndryshme dhe librave që pati lexuar më pas e që u kushtoheshin këtyre traditave.

- Është e mira të mësosh dhe të dish sa më shumë për të parët e tu, - e pati porositur babai atëherë, - ti tashmë nuk je i vogël. Duhet ta ruash traditën tonë. Në të vërtetë janë parime e norma patriarkale, por janë shumë të rëndësishme, ndaj duhet t'i mësosh e t'i respektosh me fanatizëm. Për këto cilësi të parët tanë, - kishte vazhduar ai, - kanë sakrifikuar jetën. Fiksoji mirë gjërat e shenjta të të parëve tanë: fjalën e dhënë, nderin, besën, mikpritjen, mirënjohjen, besimin, punën, sakrificën, vetëpërmbytjen, ekuili-brin, respektin etj., - kishte përfunduar i ati, e ndërsa Antoni e pikaste se vështrimi i tij krenar dhe i zjarrtë kërkonte rrënjët e një tradite që vlen edhe për nesër.

Kur babai ia numëronte të gjitha këto me seriozitet dhe solemnitet, Antoni dëshironte ta dëgjonte me respekt çdo fjalë dhe t'i memorizonte ato.

Nuk i shkulej nga mendja simboli se kulla nuk kishte qenë thjesht një vend strehimi apo banimi, por ajo në vetvete qe një institucion unik etno-kulturor, një ngrehinë shpirtërore dhe një tempull besimi dhe lirie. Legjendat tregonin se, në kështjellat dhe objektet

e mëdha flijoheshin jetë njerëzish që muroseshin në themele. E tillë ishte legjenda për Kalanë e Rozafës apo e urave të mëdha, të ndërtuara në lashtësi e mesjetë. Kurhani i tyre ishte jeta e një njeriu që bëhej theror që themelet të qëndronin të forta. Kullat në Saukull që ishin gati treqindvjeçare, në themelet e tyre kishin kurban një dash. Kështu ishin gojëdhënat, kështu vazhdohej akoma në Saukull. Në çdo rast që hidheshin themele për një shtëpi të re murosej një kokë dashi. Kështu ishte përcjellur historia deri te babai i Antonit. Në kohët e mëvonshme, Antoni kishte mësuar se tradita e këtyre riteve mijëravjeçare vinte nga periudhat kur ishin ndërtuar tempujt e lashtë në Dodonë, Delf etj. Spërkatja e themeleve me gjak glorifikonte simbolikën e sakrificës njerëzore për shpirtin hyjnor. Kjo traditë ekzistonte edhe për ndërtimin e kullës shqiptare.

Antoni e shihte qartë simbolikën unike të sakrificës të gjaku të kurbanëve në themelet e gurta. Kur dëgjonte të vjetrit se “liria jonë i ka rrënjët në gjak”, atij i kujtoheshin mitet dhe legjendat, si dhe praktikatat e derivonshme të flijimeve. Shembujt i tregonte historia e lashtë, që nga përgjakja e arkitektit të tempullit të Solomonit, Hiram Abif e deri te legjenda e Rozafës në Shkodër, ku ishte derdhur gjak për të simbolizuar sakrificën në mbrojtje të tempullit. E njëjta gjë kishte ndodhur edhe në kullën shqiptare.



Në Saukull dallohej ndryshimi mes kullave. Sipas fuqisë ekonomike dhe madhësisë “demografike” të secilës familje, vihej re dhe ndryshimi mes kullave; nga lartësia e ndërtesave, përmasat, madhësia, trashësia dhe fortësia e murit të kullave etj.

Kulla e Hilajve, ku qëndroi Antoni me pushime, kishte mbetur po e njëjta qëkur ishte ndërtuar. Ajo ishte e ndërtuar me tri kate. Kishte mure të trashë dhe të fortifikuar mirë. E gjitha me gurë të gdhendur. Dritaret ishin ndërtuar në atë mënyrë që shërbenin për të thithur dritën por në raste luftrash për të sulmuar nga brenda jashtë. Qemerët e rrumbullakët të dyerve e dritareve ishin montuar nga mjeshtra të vërtetë, me një arkitekturë e fortësi të admirueshme. Kulla nga jashtë dukej si një kështjellë. “Edhe njerëzit, si kullat janë”, mendoi një herë Antoni, “Kulla të lëvizshme”.

Në katin e parë të kullës ndodhej magazina e freskët, ku mbaheshin zahiretë e dimrit. Në katin e parë ndodhej një dhomë e madhe, së paku dhjetë metra e gjatë dhe nja shtatë apo tetë metra e gjerë. Ky ishte ambienti i grave të shtëpisë, të cilat gatuanin dhe bënë shërbimet e tjera. Ngjitur me të ishte një kthinë, ku ndodhej mokna e cila shërbente për të bluar drithin. Ajo tashmë nuk përdorej, ama e kishin mirëmbajtur si një relike për të kujtuar kohët e largëta. Ajo përbëhej nga dy gurë të rëndë, më të vegjël se gurët e mullirit, që vendosishin sipër njëri-

tjetrit në një mbajtëse druri të ngritur mbi tokë në lartësinë e mesit të burrit. Guri i sipërm rrotullohej me forcën e krahut nëpërmjet një huri të gdhendur e të lëmuar, i cili ishte i fiksuar në tavan. Maja e poshtme e hurit ishte në një gropëz të krijuar në pjesën ballore të gurit të sipërm, në syprinë, në cepin e saj për të krijuar mundësinë e rrotullimit. Guri i poshtëm qëndronte gjithnjë i palëvizshëm. Kokrrat e drithit binin në hapësirën e rrumbullakët, të gdhendur në qendër të gurit të epërm. Poshtë gurëve ndodhej një mekanizëm, që nëpërmjet një pyke rregullohej distanca mes dy gurëve të rëndë e që për pasojë, ajo rregullonte dhe mundësonte bluarjen e imët apo të trashë të drithit, sipas dëshirës. Sa më shumë shtyhej pyka që ishte e hollë në majë e pastaj vinte duke u zgjeruar, aq më shumë ngrinte gurin e sipërm, e mielli dilte më i trashë. Por dhe rrotullimi i gurit bëhej më i lehtë. Mielli i bluar dilte nëpërmjet një daljeje të vogël në pjesën e përparme dhe përfundonte në depozitën prej dërrase të lëmuar. Aty ndodhej një lopatë e vogël druri, që shërbente për të nxjerrë miellin nga depozita e për të mbushur trastat. Në situata luftrash apo dimri të stuhishëm, kur nuk mund të shkoje në mulli për të bluar, kjo moknë prodhonte miellin pa dalë nga shtëpia. “Mulliri i gurit, si truri njerëzor që bluan mendime, herë trashë e herë hollë”, paralelizonte me vete Antoni.

Në katin e dytë të kullës ndodhej oda e burrave. Ajo ishte e dekoruar thjesht dhe simbolikisht me dru në dysHEME e në tavan, me oxhak, mbajtëse qirinsh, llampa vajguri etj. Kjo odë e madhe ishte tempulli më i shenjtë i asaj kulle. Në këtë odë priteshin miqtë dhe qëndronin gjithmonë meshkujt e shtëpisë, derisa më pas flinin në dhomat e tjera të kullës, në pjesën tjetër të katit të dytë dhe në katin e tretë të saj. Në këtë odë, muret nuk ishin të ngarkuara shumë. Ishin të lyera vetëm me gëlqere të bardhë. Në të dyja anët ishin të shtruar qilimat punuar me lesh deleje, të thurur në mënyrë artizanale me punim tradicional, me figura simetrike e me ngjyra të ndryshme. Sipër qilimit, përreth mureve ishin shtruar shilte prej pambuku, të mbuluara me shtroje të mëdha dashi me lesh të gjatë me ngjyrë të bardhë. Afër derës ndodhej një tryezë e vogël, sipër të së cilës ishin vendosur një tabaka e gdhendur bakri me dymbëdhjetë filxhanë kafeje, një xhezve e madhe kafeje, një baule me sheqer, një bilor uji me mbulesë sipër dhe disa gota të rreshtuara në anë. Në njërin anë, dhoma kishte të varur një lahutë shumë të vjetër, dy çifteli dhe një sharki e madhe. Në anën tjetër ishin vetëm dy fotografi bardhë e zi, që ishin dy vëllezërit, gjyshërit e fundit të asaj kulle, që Antoni nuk i kishte njohur. Ata në fotografi paraqiteshin me fytyra të ngrysur, me mustaqe, me qeleshe dhe të veshur me tirqe e xhurdinë ngjyrë qumështi, stolisur me thurje që përbënin shirita të zinj, si dhe

këmisha të bardha pa jaka, të mbërthyera deri në grykë. Ngjanin shumë të dy. Mes dy fotografive zinte vend një orë muri shumë e vjetër, e cila krijonte tiktakun e saj e që dëgjohej pothuaj në çdo cep të asaj ode të madhe. Kjo odë kishte katër dritare të gjera, dy nga lindja dhe dy nga jugu. Dritaret ishin të gjera nga brenda, por ngushtoheshin e përfundonin në frëngji kur binin në kontakt me dritën e jashtme. “Odat – dhoma senati për çdo lagje”, - përkufizonte me mendje Antoni, gjithë atë institucion tradicional ku mblidheshin burrat e kullës dhe të fshatit.

Ngjitur me dhomën e miqve qe një kthinë, që Antonit i ishte dukur si muze i kësaj kulle kështjellë. Aty kishte parë libra të vjetër, të sistemuar në një arkë të vjetëruar. Ato libra përmbanin shkrimet e shqipës së vjetër. Disa libra të tjerë ishin në gjuhë të huaj, ca në italisht, ca në turqisht e ca në latinisht. Nga kapakët e vjetëruar me ngjyrë si ndryshku në të hirët, të brejtur në cepat e tyre, nga minjtë apo nga mosha e vjetër e tyre. Mund të ishin të vjetër ata libra, sa vetë kulla e mbase më shumë. Kishte dhe disa revista e gazeta shumë të vjetra, ca harta të zverdhura që ngjanin si vizatime në një pergamenë lëkure të thatë e të vjetëruar. Në një tryezë ishte vendosur Ungjilli i vjetër me kapak lëkure e, ngjitur me të, një libër Kanuni me kapak kartoni. Në njërën anë të kthinës ishin të varur tri pushkë që duhet të ishin shumë të vjetra. Asnjëra me tjetrën nuk ngjanin për nga gjatësia, vjetërsia dhe përmasat. Duhet të ishin

relike të mbetura nga luftëra të ndryshme që kishin përfshirë Saukullin në qindra vjet. Gjithashtu, ishin të varura dy shpata të mëdha dhe tri kana që ishin me madhësi sa gjysma e shpatave. Dukeshin se ishin të vjetra nga ndryshku i mbështjellësve të tyre. Në një cep ishte një kryq i madh prej bronzi, i cili dytri vite më parë kishte qëndruar në ballë të oxhakut, por tashmë që kjo nuk lejohej e kishin ruajtur në këtë kthinë të fshehtë të kullës.

Vite të shkuara, por edhe ato ditë, kur Antoni kishte qëndruar aty, mësoi se tradita nuk lejonte hyrjen e femrave në odën e burrave. Ushqimet, kafja, pijet e çdo gjë tjetër sillej nga gratë e shtëpisë deri në korridor, por nuk mund të hynin brenda. Veçanërisht kur në odë ndodheshin mysafirë. Kur në odë nuk ndodhej askush ajo pastrohej e sistemohej nga gratë e shtëpisë. Gjithashtu, ai ishte çuditur shumë kur pati vënë re se, nuk mund t'i ofrohej kafeja atij personi të ulur në fund apo në mes të dhomës, përpara atij që është ulur pranë oxhakut. Qëndronte një radhë e fiksuar se kujt i takonte kafeja të parit dhe se si duhej respektuar radha më pas. Shërbimi përmbante një ceremonial që duhej respektuar me fanatizëm. Në kohë ishte mësuar se një gjest i gabuar, sado i vogël, krijonte fyerje në respektimin e këtyre rregullave dhe shkaktonte incident të rëndë. Ndaj, ata që hynin në odën e burrave, duhej të ishin të kujdesshëm për të zbatuar një seri normash dhe rregullash që ishin të pashkruara.

Në një odë të tillë duhej të gjithë të ndiheshin të barabartë. Kjo barazi realizohej duke vënë në zbatim disa kriterë në hierarkinë e odës, kriteri i moshës, i largësisë gjeografike dhe lidhjes së gjakut, kontributit të njohur shoqëror etj. Askujt në odë nuk i mohojë e drejta e fjalës, por nga ana tjetër nuk lejohej keqpërdorimi i saj dhe përdorimi i fjalës pa leje. Nuk lejoheshin kurrsesi fjalët në vesh ose biseda të ngushta që nuk i dëgjonin të gjithë burrat e pranishëm në dhomë. Flitej me radhë dhe dëgjoheshin të gjithë.

Oxhaku i odës simbolizonte pjesën më të rëndësishme të kullës. Shërbente edhe si vatër zjarri për ngrohje në dimër, por edhe si pikë orientimi për uljen e të pranishmëve, sipas rëndësisë. Në dy krahët e oxhakut, njerëzit uleshin duke respektuar “gradën” dhe “pozitën” e gjithsecilit. Bëhej kujdes që mysafiri të ulej në një vend nderi sa më të merituar, pa cenuar dikënd tjetër. Kishte ndodhur, që vetëm pse nuk i ishte gjetur vendi i merituar në odë një personi, ai të largohej duke i lënë turp kullës së mikpritësit. Këto raste ishin zgjidhur nëpërmjet një procesi gjyqësor mes pleqsh të urtë, me autoritet e të pranuar nga të gjithë.

Një mësim tjetër që Antoni kishte mësuar atje, ishte se çdokush që hynte në odë, në të shkuarën kur të gjithë mbanin armë, ka qenë i detyruar që armën personale t’ia dorëzojë të zotit të shtëpisë. Ai, me respekt, e merrte armën dhe ia vendoste

diku në fundin e odës ku ndodhej një dollap special i posaçëm. Kur i mbylleshin kanatët dollapit nuk dukej ç'kishte brenda. Lënia e armatimit në duart e të zotit të shtëpisë kishte kuptimin e dorëzimit të besnikëria e mikpritësit dhe bëhej për të hequr armët si mundësi për ndonjë të papritur. Edhe nëse fjalët liheshin peng në odë mes dy a më shumë personave, ato i lanin hesapet vetëm pasi ishin larguar nga territori i kullës dhe fisit mikpritës dhe, së paku, njëzet e katër orë pas ngrënies së vaktit që kishin lënë fjalët peng. Lënia e fjalëve peng ishte në fakt deklaram luftë, por sipas rastit, edhe këtu, bëhej e pamundura për ta tejkaluar. Mblidheshin pleqtë dhe me urtësinë, maturinë dhe drejtësinë e tyre, përpiqeshin të shmangnin dhunën. Ata, për çdo rast, jepnin masa dënimi të parashikuara në Kanun.

Në odë, gjithkush që ulej kishte të drejtën e fjalës, përveç atyre që shërbenin. Mirëpo fjala merrej me lejen e kryeplakut, që rrinte ulur këmbëkryq në krye të oxhakut. Po ky ishte përgjegjës për kohën që i jepte në dispozicion një personi apo një tjetri për të folur. Në odë nuk lejohej përdorimi i fjalëve banale dhe atyre që nxisnin keqkuptime. Edhe romuzet apo alegoritë lejoheshin deri në një masë që nuk prekej nderi dhe personaliteti i dikujt tjetër. Oda, natyrisht kishte edhe momentet e veta të prehjes. Kishin momentet kur lejohej ndonjë gaztor, këngëtar ose kur merrej vallja, tregoheshin bejte, histori, bëheshin lojëra të ndryshme etj.

Kullat e vjetra në atë fshat ishin ruajtur pothuajse të gjitha. Ndodheshin jo shumë afër njëra-tjetrës, të shpërndara në shpatin e një pllaje të madhe e ku më sipër shtriheshin majat e larta të maleve dhe bjeshkët ku veronin bagëtitë. Në fshat vetëm kisha e vjetër romane që rrënuar barbarisht. Ishte shembur, aq sa dukeshin vetëm disa nga rrënojat e vjetra. Ajo ndodhej në mes të katundit, në një shesh shumë të bukur, rrethuar me pemë të larta. Nuk kishte shumë kohë që ishte rrënuar. As tri vite. Regjimi komunist kishte prishur të gjitha objektet e kultit, përfshirë dhe kishën e vjetër të Saukullit. Dukeshin themelet dhe një pjesë e murit sipër tyre me gurët e latuar. Pjesa tjetër ishte shembur dhe lënë ashtu gërmadhë. Ishte e dhimbshme. Nuk lejohej të flitej për të dhe historinë e saj.

Antoni kishte shëtitur lëndinave jashtë fshatit, madje mbante mend emrat e tyre si: Pëllumas, Mollëz, Vramja e Dheut, Pasnuçe, Shpac, Ara e Kishës, Guri i Shqipës etj. Ishte ngjitur në kreshtat e larta të maleve, nga ku vështrimi zgjerohej pa fund në territore majë malesh dhe në qiellin që ishte aq afër. Kullat ishin parzmoret e gurta të fshatit përballë luftërave qindrvjeçare.

Kur Antoni kishte pyetur me kuriozitet për kullat e ngujimit, i thanë se në Saukull nuk ka patur. Ato, siç i kishin treguar të vjetrit e atyre anëve, nuk ishin për të gjallët. Antoni kishte kuptuar se kullat e ngujimit ishin si sarkofagë për të vdekurit, jo për



burrat e gjallë të katundit Saukull... Fatmirësisht trungu i familjes së Antonit nuk kishte provuar gjakmarrjen. Ata kishin luftuar vetëm me të huajt. Kishte dhe të vrarë nga paraardhësit e tij, por kurrë fati nuk i përplasi me krahinarët e vet.

Vite më vonë Antoni i kushtoi vëmendje studimit të At Shtjefën Gjeçovit, i cili përmbledh të gjitha normat e sjelljes në Kanunin, që mban emrin “Kanuni i Lek Dukagjinit”. Aty janë të sistemuara një seri dokesh, ligjesh e rregullash të Veriut, që përcaktojnë mënyrën e funksionimit të jetës së shqiptarëve në qindra vjet. Këto doke e zakone ishin pikërisht ato që ai kishte mësuar për kullën e të parëve të tij në Saukull. Kjo i kujtonte babain e tij, rrënjët dhe historinë e brezave nga ku ai kishte ADN- në e vet.

Edhe historitë e treguara nga i ati i tij për njerëzit atje në ato vise e tregonin ashpërsinë e tyre. Këtë mënyrë sjelljeje e kishin nga pastërtia në shpirt dhe çdo cenim i gjërave të tyre të shenjta, përballej me reagim të fortë. Cenimi ngjante me ndotjen e ajrit që thithnin çdo moment, ndaj rebelimi ishte i menjëhershëm.

Jeta në shekuj ishte përshkuar nga luftëra të pandërprera. Me dhjetëra emra ishin të skalitur si patriotë që kishin dhënë jetën për të mbrojtur atdheun e tyre. Dhe pozita gjeografike afër kufirit i kishte përballë brez pas brezi me pushtues. Pushka e lufta kishin qenë bashkudhëtare të të gjithë brezave

në ato bjeshkë. Ishin krenarë me të drejtë për trojet e tyre të larta e të bukura pranë qiellit e pranë Zotit.

Ndërkohë që udhëtonte në luginën e lumit rrethuar me male, Antonit i erdhën në mendje këto grimca jete nga trojet e të parëve. Kur kujtonte kullat me meshkuj në malësi ndiente pak trishtim. Tashmë Anton Hila ishte krejt i vetëm, por kjo nuk e brengoste. Ai ishte ambientuar dhe i pëlqente kjo mënyrë jetese.

Më shpesh se “kullat”, Antoni e kujtonte shpesh dashurinë e tij të parë me emrin “Eli”, me të cilën nuk arriti të martohej kurrë. Mallëngjehej dhe e vuante si një peng brenda vetes që, në kulmin e rinisë së tij, u dashurua rrëmbimthi. Ajo dashuri u shua e mori fund, jashtë dëshirës së zjarrtë. Eli mbetej në mendjen e tij ashtu e re, e bukur, bjondina dhe elegantja simpatike e shkollës. Mësuesit e thonin se ajo qe vajza më e bukur e brezit të saj. Do ketë ndryshuar vallë, bukuria e saj me vitet që kanë kaluar? Donte me shpirt ta shikonte në këtë kohë, por ishte e pamundur. Ai donte që ajo të mbetej në mendje ashtu siç ishte në atë kohë. Ishin ndarë dhe fati i tyre eci në shtigje të ndryshme. Qëkur kishte mësuar për martesën e saj donte të mos e kujtonte më atë lidhje, ta harronte.

Në çdo njohje të re, në biseda dilte në pah refuzimi i tij kundër martesës, për të mos i dhënë shkas asnjërës të mendonte e të ëndërronte bashkimin e fatit me këtë njeri. Para rreth dhjetë vitesh kishte

menduar njëfarë kohe seriozisht të binte dakord me ndonjëren nga të dashurat që i pëlqente, për të patur një fëmijë. Shpejt kishte hequr dorë.

Atij i dukej vend i papërshtatshëm për të rritur një fëmijë siç donte ai. Vendi ku jetonte përditshmërinë e tij ishte vend problematik, i pastabilizuar dhe depresiv për shoqërinë. Nga ana tjetër, nuk ishte tip që mund të duronte kërkesat e paana të grave që kishin kushte për t'u përkushtuar në një lidhje martesore. Atij i dukej një gjë e paarritshme ta përballonte këtë situatë. Çuditej nga të njohurit e tij kur nënshtroheshin nga tekat e grave, zbatonin pa kushte kërkesat e tyre, nganjëherë dhe groteske. Prandaj, dalëngadalë po e braktiste vullneti për të ndërtuar një lidhje “për fare”. Sigurisht që ai nuk ishte një murg. I donte shumë njerëzit dhe i pëlqente të jetonte mes tyre. Kishte miq shumë të mirë, ngado që shkonte. Kishte pëlqyer më shumë lirinë, sesa krijimin e një familjeje. Me kalimin e viteve, e bindte veten se kishte bërë gjënë e duhur. Ishte i lumtur me veten që kishte zgjedhur këtë mënyrë jetese.

Në pasditen e vonë, kur mbrëmja po zbriste heshtur nga malet, ai sapo hyri në qytetin e vogël të Drinasit. Nuk ndihej shumë i lodhur, sepse herë pas here qe ndalur rrugës, për disa pushime të shkurtra, për të fiksuar disa foto nga peizazhet e natyrës së bukur. Si një çlodhje më vete i shërbyen kujtimet e dikurshme. Dreka në një restorant tradicional

në bregun e lumit kaltërosh, nën hijen e rrepeve shekullore dhe zhurmës gurgulluese të lumit të rrëmbyeshëm, i dha fuqi e dëshirë për më shumë udhë, sesa kishte mbetur. Për këtë lumë nuk mund të thuhej se gjarpëronte blu apo gjarpëronte jeshil përmes grykës së gjerë, që mbante në të dyja anët e saj fshatra dhe qyteza të vogla, plot jetë.

Një prej tyre ishte edhe Drinasi. Një qytet me rrënjë të lashta. Nëse e shikoje nga mali përballë, dukej si një plak magjik, ulur në një stol guri, rrethuar me malet e blerta. Një plak tipik i asaj krahine, veshur me fustanellën e bardhë, brezin ngjyra-ngjyra, flokët dredha-dredha, takijen me majë dhe jelekun me vija të trasha. Plaku-qytet, me pamjen hijerëndë zgjaste këmbët në lumin që kalonte me drojë atypari.

Dhjetëra dekada më parë ishin ndërtuar rishtaz disa qyteza të reja, qyteza punëtorësh të fabrikave dhe uzinave të para. Në përgjithësi, si qytezat e reja, si ato me moshë mijëravjeçare, kanë një të përbashkët: një lumë që i përshkon mespërmes ose që u kalon diku aty afër. Nuk ka kuptim një qytet apo vendbanim pa një hapësirë ujore në mjedisin e tij. Edhe Drinasi, qyteti qindravjeçar, kishte lumin e tij, që nuk e përshkonte mespërmes si shumicën e qyteteve që kishte vizituar Antoni, por i kalonte përgjatë pjesës fundore, duke freskuar këmbët e qytetit, sidomos në verë.

Me përtesë nga rruga e gjatë që kishte përshkuar gjithë ditën, në hyrje të qytetit, Antoni e drejtoi

timonin në të djathtë dhe, duke u ngjitur rrugës lart, u fut në lagjen e vjetër, ku do të qëndronte për disa kohë. Në njërën nga ambientet me qira të një ndërtese të vjetër karakteristike të qytetit do të qëndronte gjatë kohës që do të ishte në Drinas. Ai konstatoi se pjesa e re e qytetit kishte ndryshuar që nga koha, kur e pati vizituar për herë të fundit. Ndërtesat e reja, pallatet e larta, zgjerimi i rrugëve dhe trotuareve, lulishtet e mbajtura me kujdes, lokalet dhe dyqanet e kuruara me shije moderne, i ranë në sy sapo hyri në qytet. Në shpatet e kodrinave ishin shtuar shtëpitë e reja prej guri, që ruanin të njëjtin stil tradicional si ato më të vjetrat, duke krijuar një ansambël arkitektonik të veçantë. Shtëpitë e vjetra ishin të ndërtuara prej qindra vitesh, ngjitur me njëra-tjetrën dhe mes tyre, si labirinthe, ishin rrugicat e kalldrëmta që gjarpëronin mepërmes sokaqesh të ngushta, tipike për atë qytet muzeal.

Pavarësisht risistemimit urban, Antoni, pa shumë mundim, e gjeti adresën e banesës ku do të qëndronte.

Pasi parkoi makinën në një parking të vogël, ngjitur me banesën ku do të rrinte, i ra ziles së shtëpisë. te dera u shfaq një grua e moshuar, fytyrë - rumbullake, te të gjashtëdhjetat, e shëndetshme, me flokë të shkurtër dhe të lyer me ngjyrë gështenjë. Në mes portretit të plotë dhe të qetë, paksa të

mbushur, dy sy të zinj të futur thellë në guaskat e fytyrës, lëvizën me gjallëri dhe kujdes, a thua se prej kohësh po rrinin në pritë. Ajo tha se po e priste mysafirin e ri, të cilin e përshëndeti dhe i uroi mirëseardhjen, duke i treguar se duhej të ngjitej lart në katin e dytë, ku gjendej ambienti me qira. Pastaj e ndihmoi Antonin të sistemonte çantën te dhoma e tij e pushimit dhe nisi t'i tregonte disa hollësi që duheshin mbajtur mend. Në hotele të tjera jashtë vendit, Antoni, këtë listë "rregullash shtëpie", që zonja kujdestare po ia recitonte, i gjente zakonisht të shkruara prapa derës ose te komoja e vogël ku vendosej telefoni ose abazhuri.

Dhoma ishte e madhe, me një krevat të gjerë, të vendosur në anën veriore, me televizorin në një tavolinë prej druri përballë krevatit, me dollapin e rëndë prej dërrase të vjetër, ku do të sistemonte rrobat e tij. Në njërin anë të krevatit ishte një etazhier. Brenda ishin të sistemuara pak libra, që dukeshin të vjetra. Dhoma kishte dhe një ballkon të vogël nga ana lindore, pra nga pjesa e rrugës, pasi nga ana tjetër vinin ndërtesa të tjera, që dukeshin ngjitur me njëra-tjetrën, sikur mbështeteshin e shtrëngoheshin te njëra-tjetra, e nuk dalloje se ku mbaronin, mbase deri në krye të rrëpirës. Kështu shtriheshin zinxhirë lagjet e vjetra në Drinas. Shtëpia ishte e vjetër, madje shumë e vjetër. Muret e trasha prej guri bashkë me trarët dhe dërrasat në anët e saj e tregonin këtë që larg. Në përgjithësi, të gjitha

banesat ishin të ndërtuara me mure guri dhe brenda ishin të veshura, që nga tavani deri tek orenditë me dru dhe dërrasa të gdhendura, kryesisht me ngjyrë kafe. Pastërtia dukej në çdo cep të asaj banese.

Në tryezën e dhomës, Antoni vendosi laptopin e punës dhe te rafti dykanatësh sistemoi me kujdes rrobat që kishte sjellë me vete.

Vasilika, e zonja e shtëpisë, iu afrua te dera e dhomës së tij dhe, pa u futur brenda, i foli për t'i tërhequr vëmendjen, që ajo ishte aty.

- Zotëri, nëse s'të vjen keq, a mund të t'i sistemoj unë rrobat?

- Jo, faleminderit, - i tha Antoni duke kthyer kokën nga ajo. Ndonëse e dinte se ajo do të gatuate, do t'i lante dhe sistemonte rrobat, do të merrej me shërbimet e tjera që ai kishte nevojë në atë shtëpi, donte t'i sistemonte vetë, si dita e parë që ishte. Përgatitja e ushqimit, larja e rrobave dhe sistemimi i ambientit, ishin të përfshira në kontratën për të cilën pati rënë dakord më herët.

- Si e dëshironi ushqimin zotëri? Keni ndonjë dëshirë? - pyeti zonja, duke i hedhur një vështrim inspektues nga koka te këmbët.

- Do të vij poshtë dhe flasim, - i tha qetë Antoni dhe vazhdonte të sistemonte me kujdes gjërat e tij.

Dhoma poshtë në katin e parë ishte ngjitur me kuzhinën, e pajisur me orendi të vjetra e të sistemuara më së miri. Në mesin e saj ishte një tavolinë e vogël me dy karrike të thurura me dru

bambuje. Ai ishte ambienti, ku herë pas here Antoni bashkë me Vasilikën do të pinin kafen. Ai, kur pa dhe gruan e shtëpisë, Vasilikën, duke pirë cigare u ndie mirë, sepse edhe ai vetë ishte një duhanxhi i pandreqshëm.

Valilika, një grua tipike e grave të atij qyteti, shumë kureshtare, u zbraz që ditën e parë duke e informuar të sapoardhurin me gjithë të rejat e ndodhura ditët e fundit në atë qytet. Mungonte vetëm një lajm – lajmi për mbërritjen e Antonit... Ajo njihnte gjithkënd aty dhe ishte në gjendje të të bënte biografinë e gjithsecilit, përfshirë dhe autoritetet që drejtonin qytetin: ata që vinin e ata që shkonin. Antoni, duke thithur cigaren dhe shijuar kafen turke të sapopërgatitur nga Vasilika, dëgjonte i habitur kur ajo tregonte për gjithçka ndodhte në atë qytet, madje dhe për të gjitha fejesat e ndarjet e ditëve të fundit, duke dhënë detaje të çuditshme për lidhjet në atë vend, ku thashethemet qarkullonin në çdo lagje e sokak. Si Vasilika besoj duhet të kishte shumë në atë qytet, por Antonit, Vasilika “e tij”, iu duk më e informuara dhe më e zonja. Ai u bind që ajo ishte padyshim burimi zyrtar i thashethemeve në atë qytet. Antoni i mirëpriti lajmet “lokale” të Vasilikës, duke menduar se kjo bëhej për ta “familjarizuar” të porsaardhurin me vendin ku do të kalonte disa kohë. Rrethuar me gjithë ato ngjarje të vogla njerëzore, ai do ndihej më ngrohtë sesa në një dhomë hoteli.





### KREU III

**P**araditen e ditës së parë të punës, Antoni e kaloi në kantierin e objektit. Mori takim me stafin që kishin filluar zbatimin e projektit të madh. Në sallën e takimeve u diskutua gjatë nga të gjithë specialistët. Antoni u informua gjerësisht se çfarë ishte bërë në fazën e parë. U tha se janë kryer punët voluminoze, që nuk ishin të lidhura me delikatesën që impononte zbatimi në vazhdim i projektit. Në hapat e mëtejshëm kërkohet vëmendje e veçantë, për të qenë strikt me projektin që duhet zbatuar në detaje. Po hynin në etapën ku çdo veprim duhet të ishte i studiuar mirë dhe i kalkuluar. Gjithçka do të bëhej sipas projektit, pasi eksperimentimi dhe devijimi nga projekti në këtë fazë e mbrapa do të ishte me pasoja. Aty do të ndërtohej një nga hidrocentralet më të mëdha në vend; një investim qindra milionë dollarë dhe zbatimin e kishte fituar një kompani norvegjeze.

Dita e parë e punës i shkoi duke diskutuar kokë më kokë me kolegët norvegjezë, pastaj me stafet e specialistëve të projektit, me inxhinierët e zbatimit, me drejtuesit e shërbimeve mbështetëse,

me specialistët e teknikës dhe të mekanikës etj. Ajo qe një ditë mjaft e lodhshme, por shumë e frytshme. Tashmë e dinte se ku ishte ai dhe pjesa e projektit për të cilin mbante përgjegjësi. Kur mbaruan të gjitha takimet dhe konsultimet, ndjeu njëfarë lehtësimi. Po mendonte për të nesërmen, e cila do të sillte surpriza të reja. Teknologjia moderne që po përdorej nga kompania e huaj, e lehtësonte mjaft procesin e punimeve dhe realizimin e vëllimit të punimeve. As nuk mund të krahasohej me disa dekada më parë, kur, për të njëjtin vëllim pune, stërmundoheshin qindra njerëz dhe makineri të amortizuara, si vetë miqësitë sporadike, herë me rusët e herë me kinezët. Një vepër e tillë hidrike do të kërkonte të paktën 7 vite punë, nëse do të fillonte diku në vitet '70 dhe do të kishte shumë më pak kapacitet prodhues, sesa kjo që po ndërtohej në afërsi të Drinasit. "Teknologjia të zbardh faqen", u thoshte shpesh Antoni kolegëve dhe bashkëpunëtorëve të tij. Madje, edhe përllongaritjet më minimale, që dikur të hanin kohë dhe nuk përmbanin siguri të plotë, tani kryheshin me pajisje kompjuterike të avancuara dhe asgjë nuk i lihej rastësisë. Dikur punohej me harta e vizatime fikse, ndërsa tani edhe me një kompjuter të thjeshtë mund ta shikojë terrenin në disa dimensione, pale kur përdoreshin programe më të përparuara.

Kur po kthehej në qytet u kujtua për të marrë në telefon mikun e tij, shokun e ngushtë të fëmijërisë, i cili punonte si prokuror në atë qytet. Sapo vajti

në shtëpi hëngri drekën dhe paradarkën, për shkak se kohën e drekës e zuri me mbledhje e biseda në punë. Pastaj nxori bllokun e vogël, ku ruante plot adresa dhe numra telefonash. Aleksandër Mrizi, bashkëmoshatar nga kryeqyteti, punonte prej disa kohësh si prokuror në Drinas. Kuptohet, që transferimi ishte bërë për t'i liruar vendin ndonjë pëllumbi me lidhje nepotike ose politike. Që kur Sandri qe transferuar këtu, Antoni vetëm nja dy herë e pati takuar në kryeqytet dhe rrallë ishin dëgjuar me telefon. Largësia dhe ngarkesa në punë ua kishte imponuar takimet e rralla, megjithëse ishin miq të pandashëm. Antoni e mori në telefon dhe takimin e lanë në orën njëzetë, te restorant “Visari”.

Antoni, në orarin e caktuar, ndodhej në verandën e restorantit dhe po sodiste peizazhin e errët poshtë parmakëve rrethues, në një kodër dominuese në periferi të qytetit. Po thithte cigaren pa e patur mendjen aty, sepse qe përhumbur në “revizionimin” e bisedave me kolegët në kantier. Një zë i njohur e ndërpreu papritmas:

- Ku je, mo Toni? Nga na mbive këtu?

- E po, ja, erdha të të shkund pak pluhurin ty...

Qeshën të dy dhe u përqaftuan. Sapo zuri vend, Sandri vijoi:

- Jo pluhuri, por balta më zuri këtej, o vlla, ke të drejtë.

- Po u more me dosjet, pluhur do të marrësh, - qeshi Antoni.

- Dosjet nuk i lëmë t'i zërë pluhuri, jo, kurse unë, me thënë të drejtën, po. Do të qëndrosh ndonjë ditë? - pyeti Sandri.

- Besoj se po, sepse jam me një projekt afatgjatë të ky hidrocentrali i ri që ka nisur. Besoj, e di, sqaroi Antoni.

- Mendova se do të ikësh nesër, ndaj dhe nxitova e dola. Ta dija se do të ishte këtej më gjatë, do ta shtyja për një ditë tjetër, se me thënë të drejtën, kam një çështje delikate në dorë, që po e hetojmë me përparësi dhe isha mjaft i lodhur. Por, më mirë, sepse edhe mua më kish marrë malli, të them të drejtën... U bë kohë më duket, që nga hera e fundit në Tiranë, apo jo?

- Nuk po rrimë shumë sonte, se edhe ti paske punë, por doja të të njoftoja se edhe unë do të jem këtu për disa kohë. Besoj deri në fund të punimeve për ndërtimin e hidrocentralit dhe, deri atëherë, besoj se ti do të kesh ikur e mua do të më zërë pluhuri... - tha Antoni.

- U dashka falënderuar kjo kompania që të paska sjellë këtu... Më mirë se kaq, nuk ka sesi bëhet, se më ke ardhur si me porosi. Shokun e mirë nuk e zëvendëson ndonjëherë as vëllai, as fëmija, askush. Ka filluar të freskohet pak këtu. Apo ju të kryeqytetit nuk e ndjeni? - pyeti Sandri.

- Atje te ne vetëm asfalti, betoni dhe makinat e rrisin nja pesë gradë temperaturën. Kurse këtu është freskët, është shumë bukur. Na bën mirë e dala

jashtë rrethit të ferrit, qeshi Antoni.

Kur erdhi kamarieri porositen pak mish dhe verë të zonës, me sallatat tradicionale dhe ujë burimi.

- Porosite shumë, - ndërhyri Antoni, se kam ngrënë vonë, në fakt.

- E po këtu vonon porosia dhe derisa ta sjellin, të ka marrë uria dy herë...

- E po mirë, ti ia di më mirë kësaj pjese, - u dorëzua Antoni.

Të dy bashkë, të ulur në njërin nga këndet e restorantit, nisën të flisnin për hallet e ditës dhe problemet e punës e të jetës.

- Ç'po bëhet me transferimin tënd Sandër? Akoma do të vazhdosh të shërbesh këtu?! - e pyeti Antoni.

Sandri, që nervozohet gjithmonë kur vinte fjala te transferimi i tij, kthente të njëjtën përgjigje.

- Miku im, - vazhdoi Sandri - unë do të vazhdoj këtu derisa në krye të institucionit qendror atje në kryeqytet të jetë Alfonsi, shoku ynë i fëmijërisë. Ti e di që transferimi apo më mirë të themi, "dëbimi" im këtu është thjesht për tekën e një inatçori dhe e motivuar nga komplekset personale të tij.

Rikthimi në Tiranë ishte një problem që e preokuponte shumë dhe pothuajse çdo ditë e mbante mendjen aty. Jo se në Drinas nuk po kalonte mirë, por pikënisja e sjelljes së tij këtu, lidhet me arsytetime emocionale të një ish-miku dhe jo me nevojën reale për një kuadër si ai që i nevojitej qytetit të largët.